



Bordi Drejtues i ODËS SË INXHINIERËVE NË FUSHËN E NDËRTIMIT, me numër fiskal 603383324, në mbështetje të: nenit 17 të LIGJIT NR. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit; dhe në mbështetje të nenit 24 paragrafi 1 nënparagrafët 1.19 dhe 1.20 të STATUTIT TË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUdhËN E PËRKOHSHME, i miratuar më datë 31.12.2024, me numër protokolli 8648/24; me qëllim të ngritjes së cilësisë së projektimit, standardizimit të praktikës profesionale, harmonizimit të kërkesave minimale për përmbajtjen e dokumentacionit teknik, mbrojtjes së interesit publik, sigurisë publike, shëndetit dhe mjedisit, si dhe harmonizimit të praktikës profesionale me legjislacionin e Republikës së Kosovës dhe praktikat më të mira evropiane, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 02.06.2026, nxjerr këtë:

### VENDIM

1. Miratohet Udhëzuesi për Hartimin e Doracakut Profesional për Përmbajtjen e Dokumentacionit Teknik në Fushën e Ndërtimit, i cili i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Udhëzuesi nga pika 1 e këtij vendimi do të shërbejë si dokument orientues dhe bazë pune për Grupin Punues të themeluar nga Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës për hartimin e Doracakut Profesional për Përmbajtjen e Dokumentacionit Teknik në Fushën e Ndërtimit.
3. Grupi Punues, gjatë hartimit të Doracakut Profesional, obligohet të marrë në konsideratë legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës, standardet profesionale dhe teknike, praktikat më të mira ndërkombëtare, si dhe kërkesat e profesionit të inxhinierit në fushën e ndërtimit.
4. Doracaku Profesional i hartuar nga Grupi Punues do t'i paraqitet Bordit Drejtues për shqyrtim dhe miratim para publikimit dhe zbatimit të tij.
5. Administrata e OIRK-së obligohet t'ia përcjellë Udhëzuesin dhe dokumentacionin përcjellës Grupit Punues dhe të ofrojë mbështetjen e nevojshme administrative gjatë procesit të hartimit të Doracakut.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit Mbikëqyrës.
- Anëtarëve Themelues të Odës.
- Arkivit të OIRK-së.

Bordi Drejtues i OIRK-së:

1. **Arsim Rapuca**, Kryetar i OIRK-së \_\_\_\_\_
2. **Mimoza Shahini**, Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së \_\_\_\_\_
3. **Kadri Morina**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së \_\_\_\_\_
4. **Afrim Demiri**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së \_\_\_\_\_
5. **Nebi Pllana**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së \_\_\_\_\_





**ODA E INXHINIERËVE  
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

6. **Bujar Jupaj**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së \_\_\_\_\_

7. **Sami Kolgeci**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së \_\_\_\_\_



## **UDHËZUES PËR HARTIMIN E DORACAKUT PROFESIONAL PËR PËRMBAJTJEN E DOKUMENTACIONIT TEKNIK NË FUSHËN E NDËRTIMIT**

### **1. Qëllimi**

Me qëllim të ngritjes së cilësisë së projektimit, standardizimit të praktikës profesionale, unifikimit të kërkesave minimale për dokumentacionin teknik dhe mbrojtjes së interesit publik në fushën e ndërtimit, Oda e Inxhinierëve e Republikës së Kosovës (OIRK) do të hartojë Doracakun Profesional për Përmbajtjen e Dokumentacionit Teknik.

Ky doracak do të shërbejë si dokument referues profesional për inxhinierët e licencuar, investitorët, autoritetet kompetente, kontrolluesit teknikë, mbikëqyrësit, institucionet publike dhe subjektet tjera të përfshira në procesin e projektimit, ndërtimit, kontrollit dhe mirëmbajtjes së objekteve ndërtimore.

### **2. Baza ligjore dhe dokumentet referuese**

Gjatë hartimit të Doracakut, Grupi Punues duhet të mbështetet në:

- Ligjin Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe ndryshimet e tij;
- Ligjin Nr. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit;
- Statutin e Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës;
- Udhëzimin Administrativ (MMPH) Nr. 06/2017 për Dokumentacionin Teknik të Objekteve Ndërtimore;
- Udhëzimet administrative dhe aktet tjera nënligjore që rregullojnë projektimin, kontrollin teknik, sigurinë strukturore, mbrojtjen nga zjarri, eficiencën e energjisë, qasshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, mbrojtjen e mjedisit, sigurinë dhe shëndetin në punë, infrastrukturën dhe fushat tjera relevante të ndërtimit;
- Doracakun/Udhëzuesin për Dokumentacionin Teknik të përgatitur nga Ministria përgjegjëse për ndërtim dhe USAID;
- Eurokodet (EN 1990 – EN 1999), standardet evropiane dhe standardet e harmonizuara të zbatueshme në Republikën e Kosovës;
- Standardet dhe specifikimet teknike të institucioneve publike dhe operatorëve të infrastrukturës.

Për çështjet që nuk janë të trajtuara në mënyrë të mjaftueshme nga legjislacioni dhe aktet nënligjore të Republikës së Kosovës, Grupi Punues mund të konsultojë:

- rregulloret profesionale të Republikës së Kroacisë për përmbajtjen dhe strukturën e dokumentacionit teknik;

- rregulloret dhe udhëzuesit profesionalë të Republikës së Sllovenisë për dokumentacionin projektues;
- praktikat profesionale të vendeve të Bashkimit Evropian të harmonizuara me Eurokodet dhe standardet evropiane.

### **3. Parimet themelore**

Doracakut duhet të sigurojë që dokumentacioni teknik:

- të jetë i qartë, i plotë dhe i koordinuar ndërmjet disiplinave projektuese;
- të përmbushë kërkesat ligjore dhe teknike në fuqi;
- të garantojë sigurinë strukturore, funksionale dhe mjedisore të objekteve;
- të mundësojë kontroll teknik efikas dhe zbatim korrekt në terren;
- të sigurojë standarde të njëjta profesionale në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

### **4. Fushëveprimi i Doracakut**

Doracakut duhet të përcaktojë përmbajtjen minimale profesionale të dokumentacionit teknik për të gjitha disiplinat inxhinierike në fushën e ndërtimit, duke përfshirë:

- Projektimin arkitektonik;
- Projektimin strukturor/konstruktiv;
- Gjeoteknikën;
- Infrastrukturën rrugore;
- Infrastrukturën hekurudhore;
- Hidroteknikën;
- Ujësjiellësin dhe kanalizimin;
- Instalimet elektrike;
- Instalimet mekanike;
- Telekomunikimin;
- Mbrojtjen nga zjarri;
- Eficiencën e energjisë;
- Mbrojtjen e mjedisit;
- Punët gjeodezike;

- Disiplina tjera profesionale në fushën e ndërtimit.

Dokumentacioni teknik për secilën disiplinë profesionale duhet të hartohet, nënshkruhet dhe vuloset nga personat e licencuar përkatës, të cilët mbajnë përgjegjësi profesionale për përmbajtjen dhe përputhshmërinë e tij me kërkesat ligjore dhe teknike në fuqi.

## **5. Fazat e dokumentacionit teknik**

Doracak duhet të trajtojë përmbajtjen minimale të dokumentacionit teknik për secilën fazë të projektimit dhe realizimit, duke përfshirë:

### **5.1 Dokumentacionin paraprak**

- studimet paraprake;
- analizat e lokacionit;
- studimet gjeodezike;
- studimet gjeologjike dhe gjeoteknike;
- studimet hidrologjike;
- studimet e trafikut;
- studimet e fizibilitetit;
- elaboratet dhe analizat paraprake.

### **5.2 Projektin Konceptual**

- konceptin teknik;
- konceptin funksional;
- konceptin strukturor;
- konceptet e instalimeve;
- zgjidhjet alternative;
- parametrat bazë të projektit.

**Koment:** Në fazën e Projektit Konceptual kërkohet vetëm arsyetimi dhe paraqitja e konceptit të propozuar. Llogaritjet e detajuara inxhinierike, analizat dhe dimensionimet kryhen në fazat e mëvonshme të projektimit.

### **5.3 Projektin Ideor**

- zhvillimin e zgjidhjes së përzgjedhur;
- koordinimin multidisiplinar;

- dimensionimet paraprake;
- raportet teknike;
- paraqitjet grafike dhe teknike.

#### **5.4 Projektin Kryesor**

- përshkrimet teknike;
- llogaritjet inxhinierike;
- planet dhe vizatimet;
- detajet teknike;
- specifikimet teknike;
- paramasat dhe preventivat;
- dokumentacionin për kontroll teknik.

#### **5.5 Projektin Ekzekutiv**

- detajet e zbatimit;
- vizatimet punuese;
- detajet e montimit dhe fabrikimit;
- koordinimin përfundimtar ndërmjet disiplinave projektuese.

#### **5.6 Dokumentacionin e realizimit**

- dokumentacionin gjatë ndërtimit;
- ndryshimet e aprovuara gjatë realizimit;
- evidencat teknike të zbatimit.

#### **5.7 Projektin e Gjendjes së Realizuar (As-Built)**

- dokumentacionin e gjendjes së realizuar;
- ndryshimet nga projekti fillestar;
- dokumentacionin për pranimin teknik dhe përdorimin e objektit.

#### **5.8 Dokumentacionin për operim dhe mirëmbajtje**

- manualët e përdorimit;
- manualët e mirëmbajtjes;
- rekomandimet për inspektim periodik;

- dokumentacionin për rehabilitim dhe rikonstrukcion.
- regjistrat e inspektimeve dhe ndërhyrjeve teknike.

**Koment:** Fazat Konceptuale, Ideore dhe Kryesore trajtohen në përputhje me UA Nr. 06/2017 dhe janë pjesë e përgjegjësisë të projektuesit. Ndërsa Projekti Ekzekutiv (Zbatues), Dokumentacioni i Realizimit, Projekti i Gjendjes së Realizuar (As-Built) dhe Dokumentacioni për Operim dhe Mirëmbajtje përbëjnë dokumentacion teknik-profesional plotësues, i cili përdoret gjatë realizimit, menaxhimit, operimit dhe mirëmbajtjes së objektit.

## **6. Përmbajtja minimale sipas disiplinave**

Për secilën disiplinë projektuese dhe për secilën fazë të projektimit, Doracaku duhet të përcaktojë:

- dokumentet tekstuale të detyrueshme;
- dokumentet grafike të detyrueshme;
- raportet teknike;
- elaboratet profesionale;
- llogaritjet dhe analizat minimale;
- vizatimet minimale të nevojshme;
- detajet karakteristike;
- dokumentacionin për kontroll teknik;
- dokumentacionin për realizim;
- dokumentacionin për pranim teknik dhe mirëmbajtje.

## **7. Dokumentacioni Digjital dhe Standardizimi i Dorëzimit**

Doracaku duhet të përcaktojë kërkesat minimale për organizimin, strukturimin, dorëzimin dhe arkivimin e dokumentacionit teknik në formë digjitale, me qëllim të unifikimit të praktikës profesionale dhe lehtësimit të koordinimit ndërmjet pjesëmarrësve në procesin e projektimit dhe ndërtimit.

Për këtë qëllim, Doracaku duhet të përfshijë:

- standardizimin e emërimit të dokumenteve, vizatimeve dhe skedarëve teknikë;
- standardizimin e kodeve të disiplinave projektuese dhe identifikimit të dokumentacionit teknik;

- strukturën minimale të dosjeve dhe organizimin e dokumentacionit sipas disiplinave dhe fazave të projektimit;
- standardet për identifikimin e revizioneve, ndryshimeve dhe versioneve të dokumentacionit;
- formatet e pranueshme për shkëmbimin, dorëzimin dhe arkivimin e dokumentacionit teknik (PDF, DWG, DXF, XLSX dhe formate të tjera relevante);
- rekomandime për përdorimin dhe shkëmbimin e modeleve BIM (Building Information Modeling), kur ato aplikohen në projekt ose kërkohen nga investitori apo kontrata;
- kërkesat minimale për ruajtjen, gjurmueshmërinë dhe arkivimin e dokumentacionit teknik në formë digjitale.
- standardet minimale për identifikimin e projektit, disiplinës, fazës së projektimit dhe numrit të vizatimit.

Koment: Standardizimi i dokumentacionit digjital synon të sigurojë organizim të njëtrajtshëm të dokumentacionit teknik, lehtësim të koordinimit multidisiplinar, gjurmueshmëri të ndryshimeve dhe shkëmbim më efikas të të dhënave ndërmjet projektuesve, investitorëve, kontrolluesve teknikë, mbikëqyrësve dhe autoriteteve kompetente.

## **8. Rezultati i pritshëm**

Doracaku duhet të përfshijë:

- standardet minimale profesionale për përmbajtjen e dokumentacionit teknik;
- modele orientuese të dokumentacionit;
- lista kontrolli (check-lista);
- shembuj ilustrues grafikë;
- rekomandime profesionale për projektuesit, investitorët, kontrolluesit teknikë dhe autoritetet kompetente;
- modele orientuese për organizimin dhe dorëzimin e dokumentacionit digjital.
- modele orientuese për emërtimin, kodimin dhe revizionimin e dokumentacionit teknik.

Doracaku duhet të shërbejë si referencë profesionale për ngritjen e cilësisë së projektimit, standardizimin e praktikës inxhinierike dhe harmonizimin e saj me legjislacionin e Republikës së Kosovës dhe praktikat më të mira evropiane.

Doracaku përcakton standardet dhe kërkesat minimale profesionale për përmbajtjen e dokumentacionit teknik. Përmbajtja e përcaktuar në këtë doracak nuk kufizon

projektuesin në përfshirjen e dokumentacionit shtesë profesional, kur kjo vlerësohet e nevojshme për të siguruar cilësinë, sigurinë, funksionalitetin dhe përputhshmërinë e projektit me kërkesat teknike dhe ligjore në fuqi.